

UDHËZIM
Nr.114, datë 4.8.2011

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.618, DATË 7.9.2006 “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS
PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”, I NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në zbatim të pikës 27, të vendimit nr.618, datë 7.9.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.618, datë 7.9.2006, është 9 300 (nëntë mijë e treqind) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.618, datë 7.9.2006, është 9 300 (nëntë mijë e treqind) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 9 800 (nëntë mijë e tetëqind) lekë në muaj për kujdestari.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2011 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2011, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në programin “Mbrotjtja Sociale”, tit.10 430, kap.1, art.606

4. Udhëzimi nr.2210, datë 25.11.2010 i Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të barabarta shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1.9.2011.

**MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera**